



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08/10/2015
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP – 03-03/3013/15
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Shef Prokurimi – Qendra Klinike Universitare e Kosovës
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtor i Përgjithshëm – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
NGA/OD/FROM:	<i>net</i> z. Hasan PRETENI <i>Am...</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Furnizimi dhe instalimi i ventilimit në platformën e amfiteatrit në telemjekësi – Ri tender”



I nderuari z. RUSHITI,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Furnizimi dhe instalimi i ventilimit në platformën e amfiteatrit në telemjekësi – Ri tender” me numër prokurimi: 701/15/205/136, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: “Furnizimi dhe instalimi i ventilimit në platformën e amfiteatrit në telemjekësi – Ri tender” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, bazuar në nevojën e sajë për furnizim dhe instalim me sistemin e ventilimit në platformën e amfiteatrit në telemjekësi, ka paraparë procedurë kuotimi për këtë aktivitet i cili është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik më 30/09/2015.

Në Njoftim për Kontratë në pikën III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional, nën-pika b) kërkohet: *Dëshmi që materiali është prodhuar apo regjistruar në së paku një vend të BE-së; Schengen-it, Britani e Madhe, Zvicër SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Zelandë e Re, Turqi.* Ju si Autoritet Kontraktues në Dosjen e Tenderit keni paracaktuar vendin e origjinës për pajisjet furnizuese. Me këtë veprim, ju si autoritet kontraktues favorizoni Operator të caktuar ekonomik dhe diskriminoni të tjerë. Ju si Autoritet Kontraktues iu jeni referuar Udhëzuesit Administrativ për produkte medicinale i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, Agjencia nuk ka gjetur elemente që ky udhëzim e mbulon edhe furnizimin me pajisje medicinale. Po ashtu edhe në dokumentin përshkrimi i materialit dhe punëve, është caktuar tek rubrika “Prodhuesi” se të gjitha pajisjet duhet të jenë nga “EU”

Qendra Klinike Universitare e Kosovës, si Autoritet Kontraktues ka obligim ligjor që ti merr gjitha masat e duhura që në aktivitetet e prokurimit mos të ketë kritere jashtë kuadrit ligjor të prokurimit publik.

Veprimet e Autoriteti Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim; Nenin 27 Dosja e Tenderit, si dhe Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale e Ligjit të Prokurimit publik, me nr 04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!